



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE

VENDIM
Nr. 3, Dt. 25.09.2007

Per miratim leje per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Shushice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Picar (ne perendim dhe veri-perendim te tij), subjektit "So.Ma.Ta", sh.p.k, Bunavi, Komuna Shushice, Qarku Vlore.

Ne zbatim te kerkesave, qe percakton, Ligji Nr.8093, Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, si dhe vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006 te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2, dt.07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "So.Ma.Ta" sh.p.k, konform formularit "E", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

VENDOSI:

- 1- Te miratohet leja per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Shushice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Picar (ne perendim dhe veri-perendim te tij), subjektit "So.Ma.Ta", sh.p.k, Bunavi, Komuna Shushice, Qarku Vlore.
- 2- Siperfaqia e dhene ne shfrytezim (per 5 vjet) do te jete 0.2 km²
E kufizuar me koodinata si me poshte:

| | |
|-----------------|-----------------|
| X 1 = 44 88 310 | Y 1 = 43 78 750 |
| X 2 = 44 88 800 | Y 2 = 43 79 130 |
| X 3 = 44 89 290 | Y 3 = 43 78 880 |
| X 4 = 44 89 370 | Y 4 = 43 79 050 |
| X 5 = 44 88 770 | Y 5 = 43 79 320 |
| X 6 = 44 88 200 | Y 6 = 43 78 830 |

- Vazhdim i Projekt - Vendimit Nr. 3, Dt 25.09.2007.

| | |
|------------------|------------------|
| X 7 = 44 90 400 | Y 7 = 43 78 750 |
| X 8 = 44 90 840 | Y 8 = 43 77 900 |
| X 9 = 44 92 160 | Y 9 = 43 78 070 |
| X 10 = 44 92 140 | Y 10 = 43 78 430 |
| X 11 = 44 90 930 | Y 11 = 43 78 050 |
| X 12 = 44 90 450 | Y 12 = 43 78 850 |

- 3- Leja e shfrytezimit jepet per 5 vjet, me te drejte rinovimi cdo 3 vjet.
- 4- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06.2007 deri me 31.10.2007, duke u ricikluar cdo vit, deri ne daten 25.09.2010, duke vazhduar:
 - nga 01.06.2008 deri 31.10.2008
 - nga 01.06.2009 deri 31.10.2009
 - nga 01.06.2010 deri 25.09.2010
- 5- Volumi i materialit qe do te merret 45 000 m³/per 3 vjet, brenda zones qe jepet ne shfrytezim.
- 6- Ngarkohet A.U.B”Vjosa” per zbatimin e ketij vendimi.
- 7- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B-se “VJOSE”

Vezir METAS



KRYETARE E K.B.U-se

Dorothe KONOMI

